



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM**  
**TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**



Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksksh.com.al

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. 2017

## NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

**1 (një) Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Arsimin e Lartë;
- Të zotërojë kompjuterin;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (preferohet anglisht);
- Nota mesatare do të jetë avantazh;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Fondit, **brenda datës 25 Korrik 2017**, si më poshtë;

- Kërkesë për punësim.
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae).
- Diplomë e noterizuar.
- Diplomë Master e noterizuar.
- Listë notash e noterizuar.
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme.
- Çertifikatë kompjuteri
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar.
- Librezën e punës.

- Fotokopje e kartës së indentitetit.
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit).
- Çertifikatë Familjare.
- Raport mjekësor për aftësi në punë.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

**Adresa:**

**Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor,  
Rruga “ Sami Frashëri” nr.8, Tel. +3554223815, E-mail: info@fsdksh.com.al.**